

04.07.2002

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**P R O C E S V E R B A L  
NGA MBLEDHJA X E KUVENDIT TË KOSOVËS  
MBAJTUR ME 4.VII.2002**

Mbledhja filloj me punë në ora 10.00

Mbledhjen e kryesoi: Kryetari i Kuvendit Akademik **Nexhat Daci**, anëtar i Kryesisë z.**Bajram Kosumi** dhe Sekretari i Kuvendit z. **Frank Boulin**.

Kuvendi i Kosovës, para fillimit të seancës, mbajti një mbledhje komemorative për Bedrush Çollakun deputet i LPK-së, vdekjen e të cilit Kryetari i Kuvendit z. Nexhat Daci e quajti humbje për Kuvendin. Për jetën e deputetit Çollaku, foli z. Bajram Kosumi. Ai tha se Çollaku në fillim të viteve 60-ta zhvilloi aktivitetet në grupet e fshehta patriotike. Në vitin 1969 arrestohet nga regjimi serb dhe pesë vite mbahet në burgun e Nishit. Ai arrestohet dhe mbahet në burg edhe dy herë, 1979 dhe vitin 1981. Pas vitit 1981 ishte në udhëheqësi të Partisë Parlamentare të Kosovës, pastaj si veprimtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës, i angazhuar në ndihmën e zgjerimit të UÇK-së, ndërsa pas luftës ishte ndër udhëheqësit e lartë të Lëvizjes Popullore të Kosovës. Në zgjedhjet 2001 ai zgjidhet deputet i Kuvendit të Kosovës. Kuvendin e Kosovës, për vdekjen e deputetit Çollaku e ka ngushëlluar edhe Gjeneral Agim Çeku, Komandant i TMK-së.

Kryetari i Kuvendit konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm shumica e deputetëve për vendosje të plotëfuqishme dhe për mbledhjen e sotme propozoi këtë:

**R e n d d i t e**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i Projektligjit mbi Pensionet në Kosovë.
3. Propozimi i Rezolutës mbi të drejtat e Komuniteteve dhe anëtarëve të tyre dhe mbi kushtet e kthimit të të zhvendosurve dhe refugjatëve.

Meqë nuk ka patur vërejtje në rendin e ditës, i njejti është aprovuar.

I

**Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Deputeti **Gojko Saviç**, dha vërejtje se është ndryshuar rendi i ditës, nga ajo që është paraparë në Kryesinë e Kuvendit. Deputetja **Liljana Keniqi** kërkoi që të shtyhen pikat e rendit të ditës

Meqë sipas saj ende komisionet nuk kanë shqyrtuar projektligjin ndërsa deputeti **Sabit Rrustemi** kërroi që të përfshihet edhe deklarata e tij, për festën e 2 Korrikut, dhe në Projektligj për pensionet të përfshihen edhe invalidët e luftës.

## II

### Shqyrtimi i Projektligjit mbi Pensionet në Kosovë

Për pikën e dytë Kryetari i Kuvendit z.Nexhat Daci tha se kishte biseduar një ditë më parë me Kryeministrin z.Bajram Rexhepin nga i cili kishte marrë përkrahjen apsolute që në Kuvend të miratohej Ligji për pensionet themelore dhe të miratohet një **V E N D I M** me të cilin kërkohet që edhe invalidët e punës të përfshihen në këtë ligj. Formën dhe mënyrën le ta formulojë Qeveria. Një lloj forme kishte propozuar edhe anëtari i Kryesisë së Kuvendit z.**Fatmir Sejdiu**.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave ,**Ali Sadriu**, tha se buxheti është i kufizuar, ministria e tij është e kufizuar për ta njojur kontributin e gjeneratave që kanë kaluar, dhe ai shkoçiti me të dhëna statistikore. Ai theksoi se mund të presim që përfitimi prej 28 euro të jetë vetëm për 6-muajtë e këtij viti por që nuk kufizon limitin për përcaktimin e nivlit të vitit 2003. Deputeti z.**Ramush Haradinaj** e ka cilësuar të dobishme propozimin për përfshirjen e invalidëve të punës në ligjin për pensionet themelore ,dhe ka kërkuar që Kuvendi të kërroi nga Qeveria dhe UNMIK-u që të inicojë Projektligjin për pensionet e punës dhe atyre familjare. Ai gjithashtu kërroi që më ligj edhe pozita e invalidëve të Luftës së UÇK-së të qartësohet pozita e familjeve të dëshmorëve dhe familjeve që kanë mbetur pa dy prindërit dhe pozita e kategorive të hendikepuara.

Ndërsa znj.**Flora Brovina** ka mbështetur Projektligjin për pensionet, dhe është hera e parë që mbrohen të moshuarit institucionalisht,por shumën prej 28 euro ajo e ka quajtur nënçmuese dhe kërroi që të përfshihen në këtë ligj invalidët e luftës dhe ata të punës. Sabri Hamiti konsideroi se janë pjekur kushtet për miratimin e ligjit mbi pensionet në Kosovë dhe ka kërkuar që në këtë ligj të përfshihen edhe kategoritë tjera të invalidëve të punës dhe të shtohet në paragraf. Në paraqitjen deputetes **Liljana Kenicit** e cila gjatë debatit Kosovën e ka quajtur “**Kosovë e Metohi**”. Kryetari **Nexhat Daci** ua tërheqि vërejtjen deputetëve, grupit parlamentar “**Kthimi**” se në të ardhmen nuk do të lejojë fyerje në Kuvend të Kosovës. Pastaj theksoi: kapaciteti im durues është konsumuar që shtatë muaj dhe unë këtë ia kam thënë Saviçit se deputetët e Kosovës duhet ta resktojnë Kornizën Kushtetuese në bazë të së cilës dhe janë anëtarë të Kuvendit të Kosovës, duhet ta respektojnë kontratën që kanë lidhur si deputetë, rregullat e Kuvendit të Kosovës dhe të gjitha dokumentet e tij në të cilat në tri gjuhë ,në shqip ,anglisht dhe serbisht shkruan Kuvendi i Kosovës, prandaj është kërkesë ndërkombëtare që të sillen ashtu. Unë sot nuk do t'ua marr fjalën por duke filluar nag seancat e ardhëshme nuk do ti lejohet askujt për fyerje, duke aluduar në shprehjet Kosovë –Metohi të cilën vazhdojnë ta përdorin. Pastaj diskutuan deputetët Petkoviç, Sadudin Berisha dhe Sylejman Qerkezi . Ndërsa **Rada Trajkoviç** kërroi nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës që të sillen në mënyrë demokratike, siç tha ajo askush s'mund ta ndalojë lirinë e të folurit. - Unë do ta përdor këtë shprehje edhe më tej-tha ajo duke kërkuar që të shtrohet në Kuvend çështja e ndrrimit të emrave të vendbanimeve, në Kosovë, dhe bëri vërejtje jodemokratike nga ana e Kryesisë së Kuvendit ,duke cilësuar se që 7 muaj kemi qenë

shumë demokratikë dhe kemi toleruar mjaft.Pastaj diskutoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë, **Rangjel Nojliq**, **Fatmir Limaj** i cili theksoi se Qeveria do të përmbushë obligimet edhe ndaj invalidëve të luftës që të gjëzojnë një përkujdesje institucionale dhe përkrahi këtë Projektligj,pastaj diskutoi **Ibush Jonuzi**, **Xhezair Murati**. Projektligji u hodh në votim dhe për aprovimin e tij ishin 93 deputetë,kundër nuk pat dhe 1 abstenoi.Kryetari shpalli ligjin të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

### III

#### **Propozimi i Rezolutës mbi të drejtat Komuniteteve dhe anëtarëve të tyre dhe mbi kushtet e kthimit të të zhvendosurve dhe të refugjatëve.**

Kryetari i Kuvendit ftoi Kryeministrin **Bajram Rexhepin** që të paraqet arsyetimet e Projektrezolutës në fjalë.Ai theksoi se ky propozim tregon se Qeveria e Kosovës është e interesuara për kthimin e njerzëve dhe dëshiron që kjo të mos mbetet vetëm deklarim verbal,për të cilën ai dha shpjegimet e duhura.**Bajram Kosumi** dhe **Sabri Hamiti** i kanë dhënë vërejtjet dhe sygjerimet e tyre të cilat ato kishin të bënин me formulimet në tekst,kështu që përveç pikës së parë e cila nuk është prekur,e dyta është ndryshuar dukshëm,sipas saj institucionet vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë thirren që fuqimisht ti zbatojnë dispozitat ligjore duke u siguruar të gjithëve të drejtën e veprimit të pronës së tyre në mënyrë të ligjshme.Në pikën e tretë në vend të fjalës komunitet është zëvendësuar të gjithë qytetarët.Pika e katërt nuk është prekur.Këto janë përkrahur edhe nga **Ramush Haradinaj** dhe nga të tjerët,ka ndryshuar edhe pika e pestë.Në vend të thirrjes shumicë qytetarëve të Kosovës ,pritet të jetë gjithë qytetarët e Kosovës.Pika e gjashtë është qytetarëve të Kosovës ,pritet të jetë gjithë qytetarët e Kosovës.Pika e gjashtë është hequr,edhe pika e shtatë është kërkuar të hiqet dhe të plotësohet me një pikë tjetër.Poashtu ka kërkuar Kuvendi që në zyren e **Z.Shtajnerit** të emërohet një shqipëtar për çëshjten e kthimit të refugjatëve shqipëtarë ,poashtu të emërohet një shqipëtar në kabinetin e Kryeministrit në rangun e Ministrit.Në rezolutë është kërkuar nga deputetët të hyjë edhe çështja e shqipëtarëve të dëbuar nga regjimi i Beogradit nga Kosova Lindore.Rreh kësaj debatuan deputetët **Fatmir Limaj,Ramadan Kelmendi,Xheydet Neziraj,Sabit Rustemi,Ilaz Pireva,Smajl Kurtishi** i cili kërkoi që të hyjë në këtë rezolutë edhe çështja e të zhvendosurve shqipëtarë nga Kosova Lindore,Medvegjë,Bujanovc dhe Preshevë.Kryetari i Kuvendit kishte hedhur poshtë dhe nuk e kishte vëré në rend të ditës një propozim rezolute të bërë nga deputetët **Oliver Ivanović** dhe **Gojko Savić**,e cila rezolutë është refuzuar nga Kryesia e Kuvendit për tu shqyrtauar në seancën e mbajtur me 4.VII.2002.Grupi parlamentar serb “Kthimi” braktisën sallën e Kuvendit dhe nuk votuan për rezolutën e Qeverisë.Rezoluta u miratua me ndryshimet e propozuara nga të gjithë deputetët e pranishëm.Për të ishin 75 deputetë,kundër nuk pat abstenim nuk pat .Kryetari i njoftoi deputetët se mbledhja e ardhëshme e seancës plenare do të mbahet me 11.VII.2002.

Diskutimet më të gjëra të deputetëve janë të inçizuara në disketën e inçizimeve që gjenden në shërbimin përkatës.

PRISHTINË  
Me 5.VII.2002  
Nr.10/2002

SEKRETARIA E KUVENDIT